



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni dimëror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 21.02.2012, ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL I KOMISIONEVE TË
PËRBASHKËTA

Në mbledhje e përbashkët morën pjesë: - kryetar - Goran Marinković, zëvendëskryetar - Elmi Reqica, anëtare Jasmina Zivkovic, Kryetar - Nait Hasani dhe zëvendëskryetar - Liburn Aliu.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesi i ICO-së Dejan Qosic, dhe përfaqësuesi nga IND-ja Dusan Radakovic

Stafi mbështetës i komisioneve : Natasha Prica, Drita Çarkaxhiu, Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi

Mbledhjen e kryesoi **Goran Marinkovic**, kryetar i komisionit.

Për këtë takim u propozua ky.

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe,

Goran Marinkovic dhe **Nait Hasani** kanë kërkuar takim të përbashkët me dy komisionet që të përafrohen qëndrimet rreth amendamenteve të komisionit funksional dhe propozimeve të Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe..

Kryesuesi - theksoi se projektligji për Fshatin Hoça e Madhe nuk shkel dhe nuk cenon të drejtat e komuniteteve.

Ai tha se pajtohet me përmbajtjen e Amendamentin 1, ndërsa propozoi që të shtohet fjala “fetare” përveç asaj “trashëgimore”, ngase në këtë fshat ekzistojnë 14 monumente fetare-Kisha.

Liburn Aliu nuk ishte i pajtimit që fjala fetare të ekzistojë në projektligj ngase në terminologjinë shkencore nuk ka “trashëgimi fetare” por vetëm “trashëgimi kulturore”, Ai dha sqarim se me shprehjen “kulturore” përfshihet edhe ajo “fetare”. Ishte i mendimit që të mos bëhet kompromis me shkencën ngase Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura ka bërë lëshime me miratimin e Pakos së Ahtisarit dhe si ligj është diskriminues, ngase ky ligj trajton vetëm një nacionalitet.

Elmi Reçica – në fjalinë e tij tha se kur bëhet fjalë për ligjet të cilat rrjedhin nga Pakoja e Ahtisarit duhet të jemi sa më transparent Ai ishte i mendimit që të sqarohet amendamenti 1 i propozuar nga Qeveria, nga aspekti i formulimeve të ndryshme në versionet gjuhësore.

Kryesuesi -tha se pajtohet me amendamentin 2, të propozuar nga komisionit funksional.

Liburn Aliu- ai propozoi që të fshihet fjala “fetare” në tërë tekstin e projektligjit. Njëherit kërkoi që komisioni për komunitete të qartësohet lidhur me amendamentet e komisionit funksional se a cenohen te drejtat e komuniteteve. Ai shtoi se komisioni funksional do ti shqyrtoj të gjitha vërejtjet dhe nëse të njëjtat janë të arsyeshme do ti adaptoj në raportin përfundimtar.

Kryesuesi - sugjeroi që të evidentohen mospajtimet e komisionit për komunitete, pastaj komisioni funksional të inkorporojë vërejtjet në tërësi duke përfshirë çështjen e trashëgimisë fetare e cila është shumë me rëndësi për komunitetin serb.

Nait Hasani - tha se komisionit funksional me angazhim dhe përpikëri të duhur ka shqyrtuar këtë projektligj. Ai konsideron se nuk ka arsye të bëhen ndryshime esenciale por vetëm ato teknike për shkak të formulimeve në versionet gjuhësore.

Kryesuesi - me theks të veçantë tha se komisioni për komunitete ka miratuar **amendamentin 1**, të propozuar nga Qeveria, ndërsa nuk është përkrahur propozim amendamenti i komisionit funksional.

Në fjalinë e tij tha se amendamenti 1 (neni 4) i propozuar nga Qeveria është çështje e pazgjidhur teknike sepse në aspektin gjuhësor nuk përputhen Ai dha sqarim se komisioni gjatë shqyrtimit të këtyre amendamenteve është bazuar në versionin në gjuhën serbe.

Jasmina Zivkovic- pajtohet me qëndrimin e kryesuesit se komisioni me shumicë të votave ka miratuar amendamentin 1, të propozuar nga Qeveria, pa përkrahje të amendamentit të komisionit funksional. Lidhur me këtë amendament ajo propozoi që të kërkohet nga sponzoruesit , të harmonizohet formulimi i versionin në gjuhën serbe.

Kryesuesi – me theks të veçantë ceku se në këtë takim për afrohen qëndrimet tona lidhur me shqyrtimin e amendamenteve individuale të komisionit funksional, në këtë përbërje.

Amendamenti 3 dhe 5, të mbështetura në tërësi.

Amendamenti 6, të ndryshohet fjala “riformulim” me fjalën “plotësim”.

Amendamentin 7, 8, 9, 11 dhe 12, të mbështetura në tërësi.

Amendamentit 10, të bëhet harmonizimi gjuhësor në fjalën “karakteristika”, në versionin shqip

Kryesuesi konstatoi se për arsye të vërejtjeve në amendamentet e propozuara nga Qeveria në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni për Komunitete dhe Kthim me datën 24.02.2012, do të ftojë të merr pjesë përfaqësuesin e Qeverisë, me qëllim të sqarimeve dhe interpretimeve në amendamentin 1, neni 4 i Qeverisë. me harmonizimin e ndryshimeve gjuhësore.*
- II. Njëkohësisht, komisioni funksional do të shqyrtojë dhe përgatitë amendamentet finale për shqyrtim në komisionin tonë, në pajtim me vërejtjet e cekura dhe se do të dalim me qëndrime konkrete.*

Takimi përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic